



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Posaçëm për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.03.2018, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Oerd Bylykbashi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Seancë dëgjimore me Akademinë e Studimeve Politike, Koalicionin për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci të Qëndrueshme dhe me Institutin e Studimeve Politike.

Marrin pjesë:

Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Musa Ulqini, Gent Strazimiri, Enkelejd Alibeaj, Dashamir Shehi, Nard Ndoka

Mungojnë:

Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Nasip Naço, Luan Rama, Vangjel Dule, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Evis Fico – përfaqësues nga Akademia e Studimeve Politike

Erjona Mulellari – Drejtore ekzekutive në Koalicionin për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci së Qëndrueshme

Afrim Krasniqi - Drejtor ekzekutiv, Instituti Studimeve Politike

Alexeu Gromov – Këshilltar i ODHIR-it për zgjedhjet

Raul Muresan - koordinator i projektit

Nicola Schmidt- Eksperte e ODHIR-it

HAPET MBLEDHJA

Oerd Bylykbashin – Përshëndetje të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Reformës Zgjedhore. Sot zoti Çuçi e ka të pamundur të jetë i pranishëm.

Komisioni e ka kuorumin, prandaj mund të vazhdojmë punën normalisht. Është planifikuar që të kemi një seancë dëgjimore me organizatat e shoqërisë civile në vazhdim të procesit që kemi hapur për t'u konsultuar, për të qenë më gjithëpërfshirës dhe transparent në punën tonë në hartimin e ndryshimeve të ardhshme në legjislacionin zgjedhor.

Fillimisht, do të doja të miratonim procesverbalin e mbledhjes që shkoi.

E keni pasur në dispozicion.

A ka ndonjë vërejtje në lidhje me procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Siç e thashë, kjo është një seancë dëgjimore me tri organizata të shoqërisë civile: Akademinë e Studimeve Politike, Koalicionin për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci të Qëndrueshme dhe Institutin e Studimeve Politike.

Akademia e Studimeve Politike përfaqësohet nga zonja Evis Fico, Koalicioni për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci të Qëndrueshme nga Erjona Mulollari, kurse Instituti i Studimeve Politike nga zoti Astrit Krasniqi.

Përpara se të nisim seancën dëgjimore, do të doja, edhe në emër të bashkëkryetarit Çuçi, t'ju informoja se çfarë është arritur deri në këtë fazë në raport me asistencën dhe ekspertizën e partnerëve ndërkombëtarë ndaj Komisionit të Reformës Zgjedhore. Ne kemi pasur një mbledhje të përbashkët me përfaqësuesit e OSBE-së, KE-së dhe BE-së për të diskutuar modalitetet dhe mundësitë e asistencës dhe ekspertizës për Komisionit të Reformës Zgjedhore.

Ndërkohë, siç ju kemi njoftuar, kemi çuar më herët shkresa ku kemi kërkuar mbështetje me ekspertizë dhe asistencë nga OSBE/ODIHRI-i, Komisioni i Venecias dhe nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe zyra e Këshillit të Europës. Kemi marrë përgjigje pozitive nga të gjithë, veçanërisht nga OSBE-ja dhe Komisioni i Venecias për ofrimin e ekspertizës, e cila do të jetë shumë e çmuar në materializimin dhe përfundimin me sukses të gjithë planit të punës, që miratua, pra të 6 kolonave që u miratuan në komision. Ndërkohë jemi duke u koordinuar me ta dhe mund t'ju them se kemi mbulim të plotë të të gjitha aktiviteteve të planifikuara në planin e punës jo vetëm të ekspertizës, por edhe të aktiviteteve të mbuluara nga ky koordinim me partnerët ndërkombëtarë në lidhje me reformën zgjedhore.

Pra, në këtë aspekt, besoj se do të kemi mundësi që sapo komisioni të përfundojë në bashkëpunim me organizatat që na ofrojnë ekspertizë, përfundojmë te kalendari se kur do të zhvillohen evente të ndryshme, komisioni të ecë me shpejtësi në fazat e nxjerrjes së konkluzioneve dhe më pas të draftimit.

Gjithashtu, përpara se të fillojmë me seancën dëgjimore, doja t'ju prezantoja delegacionin nga OSBE/ODIHR, pasi e vlerësoj shumë ardhjen e tyre në komision dhe gatishmërinë për të na ofruar asistencën e tyre këtu! Sot kemi zotin Alexeu Gromov, këshilltar i OSCE/ODIHR-it për zgjedhjet, zotin Raul Muresan, koordinator i projektit të financuar nga BE-ja, i cili do të mbulojë një pjesë të konsiderueshme të çështjeve që kemi në shqyrtim në komision, si dhe zonjën Nikola Schmidt, eksperte e ODIHR-it.

Ju uroj mirëseardhjen dhe ju ftoj që të bëni një prezantim të shkurtër të asaj që OSBE/ODIHR-i është i gatshëm të na ofrojë neve si komision!

Raul Muresan – I nderuar zoti bashkëkryetar,

Të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Së pari, përfitoj nga mundësia t'ju falënderoj që na mirëpritët në këtë takim! Do të doja të prezantoja dy kolegët e mi, Alexeu Gromov, i cili është ekspert për zgjedhjet pranë ODIHR-it, dhe Nikola Schmidt, e cila është ekspertja e caktuar për të marrë pjesë në mbledhjet e ardhshme të komisionit, kur është e nevojshme.

Në fakt, projekti i ODIHR-it për mbështetjen e reformës zgjedhore në Ballkanin Perëndimor, përveç ekspertëve që janë me mua sot, mundet të angazhojë edhe ekspertë të tjerë në fusha sipas nevojës, si në fushën e medias, në fushën e regjistrimit të zgjedhësve apo të financimit të fushatave zgjedhore.

Ne mund të ofrojmë ekspertizë verbale ose me shkrim, sidomos sa u përket rishikimeve të kuadrit ligjor, mund të jepen në mënyrë formale ose jo, ashtu sikurse mund të ndihmojmë me ndarje praktikash të mira nga vende të tjera në fushat përkatëse. Sigurisht që aktivitetet e projektit tonë do të jenë plotësuese e aktiviteteve të partnerëve të tjerë ndërkombëtarë, që ju sapo përmendët. Mund të ndajmë me ju dy raste suksesi që ka pasur projekti i ODIHR-it. Njëri rast është nga parlamenti i Malit të Zi, ku komisioni i posaçëm i reformës zgjedhore, i ngjashëm me komisionin tuaj, na kërkoi ekspertizë në rishikimin e 4 akteve nënligjore. Ne ua ofruam në mënyrë informale, të cilat më pas u diskutuan nga komisioni dhe u miratuan. Rasti tjetër është në Bosnje Hercegovinë, ku ekspertët tanë u ulën me anëtarët e KQZ-së së Bosnje Hercegovinës për të rishikuar dhe për të dhënë ekspertizën e tyre në lidhje me rregulloren e brendshme të KQZ-së. Prandaj ne presim me kënaqësi të jemi të pranishëm në takime e ardhshme të komisionit, po ashtu dhe në takimet e nivelit më teknik

me ekspertët, gjithmonë në përpjekje për të adresuar dhe zbatuar rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e kaluara.

Mund t'ju siguroj se jemi plotësisht të gatshëm dhe të angazhuar të marrim pjesë në këtë moment të punës së reformës, jemi të gatshëm të marrim pjesë në një proces gjithëpërfshirës dhe transparent, autor i të cilit jeni ju.

Ju faleminderit!

Oerd Bylykbashi - Faleminderit, zoti Muresan!

E vlerësoj shumë detajimin që bëtë në lidhje me asistencën që jeni të gatshëm të na jepni. Ajo që do të doja të theksoja është që komisionet e reformës zgjedhore të parlamentit të Shqipërisë, gjatë gjithë dekadës 2002- 2012 kanë pasur një bashkëpunim të shkëlqyer me OSBE-ODIHR-in, Komisionin e Venecias dhe partnerë të tjerë, por roli OSBE-ODIHR-it ka qenë në mënyrë të veçantë shumë efektiv në çuarjen përpara dhe gjetjen e zgjidhjeve të nevojshme, qoftë edhe me këshillat informale të dhëna gjatë procesit për të arritur në konkluzione, të cilat OSBE-ODIHR-i, në një numër raportesh e ka konsideruar Kodin Zgjedhor si një bazë të shëndoshë ligjore për të organizuar zgjedhje demokratike.

Sigurisht që ligji është i pamjaftueshëm për të përballur mungesën e vullnetit politik, e për rrjedhojë jemi në këtë fazë të re të reformës zgjedhore ku jam i sigurt që kontributi juaj do të jetë përsëri shumë i rëndësishëm dhe thelbësor në arritjen e zgjidhjeve konsensuale.

Nuk e di nëse kolegët kanë diçka për të shtuar në lidhje me këtë pikë, apo pyetje specifike për miqtë e ODHIR-it? Nuk ka!

Vazhdojmë me pjesën tjetër të mbledhjes së komisionit, me seancën dëgjimore. Unë bëra prezantimin e organizatave dhe përfaqësuesve të tyre dhe do të doja që ta kemi të qartë që secila organizatë ka maksimalisht 20 minuta kohë në dispozicion, përfshirë edhe pyetjet që do të bëjnë deputetët dhe përgjigjet që do të jepen nga përfaqësuesit e organizatave.

Fillojmë me Akademinë e Studimeve Politike që përfaqësohet nga zonja Evis Fico.

Evis Fico - Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Faleminderit për përfshirjen e Akademisë së Studimeve Politike në këtë seancë dëgjimore!

Rekomandimi konkret yni është ngritja e një qendre trajnimi për të gjithë komisionerët, të cilët do të monitorojnë zgjedhjet.

Kjo qendër trajnimi e propozuar si rekomandim nga Akademia e Studimeve Politike, duhet të ngrihet pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe, përpara se komisionerët të ndjekin procesin zgjedhor, të bëjë të mundur trajnimin me profesionalizëm të të gjithë komisionerëve dhe stafit, të cilët do të ndjekin nga afër zgjedhjet. Ne mendojmë të bëhet një

rregullim ligjor për të kthyer certifikimin nga kjo qendre, pikërisht, për komisionerë kryesorë në zgjedhje.

Gjithashtu, kishim edhe përcaktimin më të qartë të institucioneve, të cilët duhet të ndjekin nga afër ankesat e votuesve. Rekomandimi kryesor është pikërisht rritja e profesionalizmit të komisionerëve për të shmangur çdo abuzim të mundshëm në zgjedhjet e ardhshme.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit për prezantimin konciz të rekomandimeve tuaja!

Duke qenë se ka kohë të mjaftueshme për hapësirën e kohës së përcaktuar për ju, deputetët kanë pyetje në lidhje me këto rekomandime?

Fjala për zonjën Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Faleminderit, zonja Fico, për dy sugjerimet që dhatë!

Kam një pyetje për çështjen që ngritët, për trajnimin e komisionerëve: propozimi juaj është që komisionerët duhet të jenë propozime të partive politike, apo persona permanentë që menaxhohen nga KQZ-ja?

Pyetja e dytë ka të bëjë me ankesat. Në qoftë se e kuptova qartë, thatë se duhet të ketë një mënyrë të trajtimit të ankesave të votuesve. Konkretisht, mund ta elaboroni pak më shumë propozimin tuaj dhe çfarë nevojë ka për rregullim ligjor?

Faleminderit!

Evis Fico - Faleminderit, zonja Hysi!

Për pyetjen e parë lidhur me trajnimin e komisionerëve, mendojmë që këta komisionerë të jenë të pavarur nga partitë politike dhe të ketë një listë përkatëse, për sa i përket listës së KQZ-së. Të jenë të certifikuar dhe me integritet në lidhje me monitorimin e zgjedhjeve. Jo domosdoshmërisht këta komisionerë zgjidhen nga partitë politike. Kuptohet, partitë politike do të kenë komisionerët apo anëtarët e tyre, por jo domosdoshmërisht të jenë nga partitë politike.

Ajo që na intereson neve si Akademi e Studimeve Politike është trajnimi i tyre, që ata të ndjekin rregullisht procesin.

Ndërsa për sa i përket përcaktimit më të qartë të institucioneve, të cilat duhet të ndjekin ankesat, mendojmë që duhet të jenë institucione të pavarura nga partitë politike për të trajtuar ankesat gjatë procesit zgjedhor. Vetëm kështu mund të trajtohen me profesionalizëm ankesat për zgjedhjet.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Zoti Alibeaj ka një pyetje.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit!

Kam dy pyetje: së pari, te prezantimi që bëtë lidhur me trajnimin e komisionerëve, do të doja të dija nëse nga ana juaj është bërë ndonjë studim për të parë se cila është masa e joprofesionalizmit të komisionerëve, e cila ka dëmtuar eventalisht edhe miradministrimin e zgjedhjeve.

Së dyti, ju thatë që do të ishte e këshillueshme që komisionerët të jenë të pavarur politikisht. 5 mijë e ca qendra votimi, po marrim një minimum komisionerësh që janë 35 mijë me sistemin aktual, të cilët do të duhet të jenë të pavarur politikisht, një term ky që për mua është i pacaktuar. Këta janë njerëz që votojnë majtas, ose djathtas, qendrën ose ekstremin, çfarë rëndësie ka! Keni ndonjë formulë, e cila të garantojë pavarësinë e këtyre njerëzve për t'i zhveshur ata nga emocionet politike, që gjatë ditës së zgjedhjeve të mos i marrë ngasja politike?

Faleminderit!

Evis Fico - Faleminderit, zoti Alibeaj!

Në lidhje me pyetjen e parë, në përgjigjen që i dhashë edhe zonjës Hysi, thashë që komisionerët të jenë të pavarur, por jo absolutisht të pavarur. Ne e theksuam si një mundësi për të ndihmuar procesin. Pavarësia do të ndihmonte në zhvillimin më të mirë të procesit aktual. Jo domosdoshmërisht ajo pavarësi duhet të jetë absolute.

Lidhur me pyetjen tuaj të dytë, për studimin me komisionerët, se sa të pavarur janë, dhe për sa i përket formulës, Akademia vjen sot me një propozim për të ndihmuar ose për të dhënë sugjerime për zhvillimin më të mirë të procesit, apo mendimet që ka. Ende nuk ka një formulë të tillë që mund ta zgjidhë pavarësinë e komisionerëve. Ne japim një sugjerim të tillë, në qoftë se doni formula, na përfshini dhe bashkëpunojmë për këtë formulë.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zona Fico!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Faleminderit për rekomandimet që dhatë lidhur me këto dy çështje. Sistemi ankimor shqiptar është ndër më të fortët që ekzistojnë në hapësirën e OSBE-së, por sigurisht ka gjithmonë nevojë për përmirësim. Për të parë hapësirën e trajtimit të ankesave të votuesve, pa u shkëputur nga interesat e partive politike, kjo do të jetë një çështje në trajtimin edhe të rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it.

Vazhdojmë me Koalicionin për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci të Qëndrueshme, përfaqësuar nga zonja Erjona Mulellari.

Erjona Mulellari – Faleminderit!

Ju falënderoj për ftesën!

Ne kemi filluar nga puna në vitin 2013 dhe një nga projektet tona më të rëndësishme ka qenë monitorimi i zgjedhjeve të vitit 2015 në Shqipëri me 1 mijë vëzhgues vendorë të pavarur dhe të paanshëm në të gjithë Shqipërinë.

Ne mendojmë që përfshirja e vëzhguesve vendorë në monitorimin e zgjedhjeve dhe respektimi i rekomandimeve të tyre është shumë i rëndësishëm në kuadër të respektimit të standardeve në vazhdimësi duke u bazuar të paktën në monitorimin e fundit të zgjedhjeve që kemi bërë të vitit 2015, kemi prodhuar disa raporte, të cilat janë vënë në dispozicion të Komisionit për Reformën Zgjedhore, besoj edhe të komisionit tuaj, por në çdo rast do të konfirmojmë dhe do t'jua ridërgojmë përsëri.

Së fundi, pas monitorimit të zgjedhjeve, me një grup ekspertësh, kemi prodhuar një raport lidhur me një nga shqetësimet kryesore që ka dalë nga monitorimi i zgjedhjeve që ka qenë paanshmëria dhe depolitizimi i organeve të administrimit zgjedhor. Në fakt, kjo është në linjë edhe me atë çfarë tha kolegja deri tani, ku është vënë re që ka pasur shkelje procedurash të vazhdueshme nga fakti që komisionerët që kanë qenë pjesë e komisioneve të administrimit zgjedhor, organet e administrimit zgjedhor kanë shkelur procedurat për shkak të mosnjohjes, paaftësisë, mosinkompetencës së tyre për ta bërë këtë gjë edhe për arsye që janë zëvendësuar shpeshherë në momentet e fundit.

Në fakt, pyetja ime është se si ka menduar komisioni ta vlerësojë paanshmërinë dhe profesionalizmin e organeve të administrimit zgjedhor? Deri tani ju e trajtuat këtë gjë, po do të doja të dija nëse ju vetë keni një plan për këtë?

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Kanë pyetje kolegët?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Çështja e pavarësisë së komisionerëve është një çështje e debatuar për më se 20 vjet dhe ne vetë themi që komisionerët duhet të jenë të pavarur.

Kam një pyetje për ju dhe të gjithë të ftuarit, në vijim të pyetjes që bëri edhe kolegu Alibeaj: në një moment kur ne kemi ligjin për shërbimin civil, që nuk e lejon angazhimin e nëpunësve civilë në struktura partiake politike, në zgjedhje po ashtu, sepse do të thotë shpërdorim i administratës, nga ana tjetër, me këtë formulë që kemi duhen rreth 35 mijë komisionerë, të cilët duhet të jenë të pavarur, cili do të ishte propozimi konkret për të pasur zgjedhje të menaxhuara nga trupa jopartiake, por që të kemi kandidatura, të cilat nuk pengohen të aplikojnë nga pjesa tjetër e trupës ligjore që kemi, sepse këtë çështje që ju ngrini,

unë e kam ngritur para 20 vjetësh, për komisionerë të pavarur, kur kam qenë jashtë politikës. Tani që jam pjesë e saj, shoh që mezi i gjejmë komisionerët. Do të rrimë te kjo formulë, apo do të propozoni një zgjidhje tjetër?

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Keni ndonjë përgjigje për zonjën Hysi?

Domethënë, kjo është seancë dëgjimore dhe ne do të donim të merrnim maksimalen prej jush.

Komisioni do të ketë më pas axhendën e tij të punës dhe do të përpunojë zgjidhje, të cilat nuk janë që ne t'i themi sot për ju, pra se çfarë mendojmë ne se si do ta zgjidhim. Kështu që, do të vlerësonim vërtet nëse ju keni ide dhe sugjerime, aq më shumë bazuar edhe në atë që thotë zoti Alibeaj, e një pune në terren, mbledhjes së informacionit, përpunimit dhe analizimit që ju ka çuar në konkluzione.

Tani, gjithsecila prej jush, si organizatë, ka eksperiencën e saj, por të gjithë ne do t'i vlerësonim vërtet, qoftë edhe në mënyrë sintetike, qoftë sugjerimet që bëni apo edhe përgjigjet në lidhje me çështjet që ngrenë deputetët. Pra, ku mund të na ndihmoni ju me ide.

E vlerësoj që keni çuar raporte, por, sigurisht, koha jonë bën që të jemi sa më koncizë dhe, nëse ju i përmbledhni çështjet që keni ngritur në një dokument shtesë, jeni të mirëpritur ta paraqisni në komision.

Kështu që, nëse keni diçka më tepër për të thënë, edhe mbi bazën e pyetjes së zonjës Hysi, fjala është për ju.

Erjona Mulellari – Ne e kuptojmë shumë mirë qasjen tuaj dhe e kemi analizuar këtë lloj shqetësimi që po ngrini edhe ju, ama duhet garantuar profesionalizmi i tyre përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe duhet penguar moszëvendësimi i tyre në momentet kur trajnimi i tyre është i pamundur. Në periudha kohore kur një person, i cili zëvendëson dikë tjetër të trajnuar, është e pamundur ta bëjë punën siç duhet.

Oerd Bylykbashi – E kuptova. Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, është sfidë e madhe.

Po, zoti Ndoka.

Nard Ndoka – Faleminderit!

Unë kam një gjykim krejt tjetër.

Unë mendoj se komisionerët e partive politike janë ata që i kanë prishur zgjedhjet në këto vite, ndaj duhet patjetër që ne të marrim një hap për depolitizimin e kësaj trupe, pra të kemi një trupë profesionale.

Më vjen jashtë mase keq që edhe akademia thotë se domosdoshmërisht nuk do të kemi propozues. Pra, është krejt e kundërta. Ne do të kemi një trupë zgjedhore, duhet të marrim një model të vendeve të tjera. Jemi i vetmi vend në rajon që ende zhvillojmë zgjedhje me militantë partiakë, të cilët marrin urdhra partiakë, zëvendësohen herë pas here jashtë kriterëve, janë të paspecializuar, janë të prirë të zbatojnë urdhrat e liderëve të partive politike, si dhe manipulojnë zgjedhjet e partive që nuk kanë propozues në ato komisione. Pra, mendoj se ato janë e keqja e procesit tonë zgjedhor.

Ne nuk pretendojmë të kemi një trupë të depolitizuar në aspektin politik, sepse gjithsecili prej tyre mund të ketë bindje, por të kemi një trupë zgjedhore që të mos marrë urdhra, të mos jetë e propozuar nga partitë politike. Pra, mund të marrim modelin e secilit vend: të Greqisë, të Italisë, të Spanjës, por e kemi marrë Kodin Zgjedhor me elemente të veçanta spanjolle, italiane e greke, kurse administratën zgjedhore, që është kryesorja, e kemi tipike shqiptare, gjë që na e ka dëmtuar rëndë procesin zgjedhor, duke sjellë tjetërsimin e votës në këto procese.

Për ta përfunduar fjalën time, kam një pyetje për ju, meqenëse i keni ndjekur zgjedhjet hap pas hapi: ku shihet manipulimi më i madh i komisionarëve partiakë tek tjetërsimi i votës, në zgjedhjet parlamentare apo në ato lokale?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi – Ju lutem, kishit...?

Erjona Mulellari – Nëse e kuptova qartë, pyetja juaj është: në cilat raste është manipulimi më i madh, në cilat lloj zgjedhjesh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo përgjigje është praktikisht e pamundur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se është...

Oerd Bylykbashi – Në qoftë se keni një përgjigje...

Erjona Mulellari – Nuk mund të jetë e bazuar në fakte, por vetëm në paragjykime dhe opinione. Kështu që është e...

Oerd Bylykbashi – Dakord, por në qoftë se keni një përgjigje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Ndoka!

Është në mundësinë tuaj, në vlerësimin tuaj, nëse mundet dhe keni njohuri në lidhje me një çështje të caktuar.

Dakord, ju i dhatë ndërkohë konkluzionet tuaja dhe ju falënderoj!

Besoj se nuk ka çështje tjetër në lidhje me ndërhyrjen e përfaqësueses së Koalicionit për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci të Qëndrueshme.

Po ia jap fjalën tani zotit Afrim Krasniqi, drejtor i Institutit të Studimeve Politike.

Faleminderit, zoti Krasniqi!

Afrim Krasniqi – Faleminderit, zoti kryetar!

E vlerësoj faktin se jam ftuar.

Praktikisht kemi dërguar dy herë material, edhe mbledhjen e kaluar, por, siç dihet, komisioni nuk arriti të prodhonte ndonjë rezultat dhe nuk pati ndonjë reflektim.

Unë kam një material të zgjeruar dhe të detajuar me nene dhe pika përkatëse, që do t'ua vë në dispozicion të gjithë anëtarëve të komisionit, por këtu do të ndaj vetëm pikat kryesore, që mendoj se vlejné për t'u diskutuar.

Së pari, unë nuk mendoj se objekti i punës së komisionit do të arrijë të prodhojë një reformë reale nëse komisioni apo parlamenti nuk e zeron ndërhyrjen e tij për një deformim tërësor të ligjit “Për partitë politike”. Pra, baza kryesore e të gjithë problematikës zgjedhore është kontrasti i thellë ndërmjet nenit 9 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për rolin e partive dhe ligjit “Për partitë politike”, i cili është praktikisht në shumë elemente i pazbatueshëm dhe spekulativ, madje edhe pengues për një demokraci përfaqësuese.

Po marr vetëm disa elemente. Ne kemi 129 parti, në të cilat, në dijeninë time, katër kryetarë kanë vdekur, dhe zyrtarisht vazhdojnë të funksionojnë në bazë të ligjit të partive politike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kuptova.

Ne kemi 129 parti politike, nga të cilat katër kryetarë nuk jetojnë më, por ligjërisht funksionojnë, sepse ligji “Për partitë politike” njuh konceptin e krijimit të partive dhe nuk njuh konceptin e monitorimit të partive politike që ekzistojnë. Prandaj partitë, sa herë krijohen koalicione zgjedhore, janë në tregun e ofertës për të shitur siglat e tyre. Dhe ky është një nga mekanizmat që përdoret nëpër zyrat lokale në Shqipëri.

Së dyti, në lidhje me atë që quhet pronë. Ju e dini se ligji “Për partitë politike” parashikonte detyrimin e Ministrisë së Brendshme për të bërë të gjithë verifikimin e partive politike: pronësinë, ndërtesat e tyre, por deri sot nuk është bërë një inventar i tillë. Këtë e kam përgjigje zyrtare nga Ministria e Brendshme se nuk e ka bërë, madje për pjesën më të madhe nuk njohin adresat e partive.

Është koncepti i territorit. Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligji i partive politike parashikojnë që partitë të veprojnë brenda territorit. Partitë kryesore në Shqipëri kanë degë në Perëndim, në vende të tjera, çka e bën të pamundur që të kontrollohet mënyra si

funksionojnë, financimi i tyre, ndihma që japin, si dhe një sërë elementesh të tjera, që e bëjnë fiktiv të gjithë procesin që ne bëjmë në Shqipëri. Gjithashtu, ka edhe momente të tjera, tek të cilat nuk po ndalem këtu, por që bien tërësisht në kundërshtim me nenin kushtetues.

Në lidhje me faktin nëse ky nuk do të jetë objekt dhe nëse parlamenti nuk do të ketë një vendimmarrje për këtë, atëherë na ngelet çfarë mund të rregullohet me aktualitetin, me bazën aktuale ligjore.

Nëse më lejoni të bëj një sugjerim, ju keni dy nisma: një dokument të shkruar nga misioni i OSBE-ODIHR-it, i cili, pavarësisht se është rekomandim gjysmak dhe shumë diplomatik, për të qenë plotësisht korrekt me Shqipërinë, ka elemente pozitive, por mendoj se ky duhet të jetë objekti i parë dhe i panegociueshëm i punës së komisionit. Shqipëria penalizohet nëse ju nuk i realizoni këto lloj detyrimesh dhe që nuk janë realizuar që prej vitit 2005. Kështu që shpresojmë kësaj here të realizohen.

Frika ime është se, duke vendosur një prioritet tjetër me votën e emigrantëve dhe teknologjinë elektronike, do të tërhiqet vëmendja në çështje të tjera dhe kjo do të dalë dytësore, duke sjellë ndoshta përsëri probleme për atë që quhet standard i demokracisë në Shqipëri.

Një element tjetër, ne patëm atë eksperimentin e qeverisë teknike. Janë bërë disa gjetje dhe vetë fakti se ekzistoi te disa ministra teknikë, do të duhet ta shtyjmë për të parë një reformim tërësor të të gjithë kapitujve, që lidhen me sjelljen e administratës dhe burimeve shtetërore.

Nëse Presidenti i Republikës detyrohet ta shpallë me dekret nëntë muaj përpara, atëherë edhe koncepti i periudhës zgjedhore duhet të fillojë nëntë muaj përpara ose le të ndryshojë data e referimit të Presidentit. Pra, shqiptarët duhet ta dinë që nëntë muaj përpara se ku do të shkojë buxheti i shtetit, cilat janë financimet e parashikuara, cili është numri i punonjësve në administratë, sa do të merren me kontratë, cilat janë masat e privatizimit me paratë publike, si dhe elemente të tjera, që na reflektohen gjithmonë në problematikën zgjedhore.

Nëse ne i monitorojmë vetëm për 45 ditë sa na kërkohet, praktikisht ka mbaruar punë dhe ato 45 ditë janë më shumë show politik. Kështu që, nëse mbahet kjo datë, duhet të jetë pikë referuese për të gjitha elementet kjo datë.

Po ashtu, do të duhet të ketë një ndërhyrje ligjore për të parashikuar se cilët janë zyrtarët e shtetit që do të duhet të japin dorëheqjen apo të pezullojnë funksionin e tyre gjatë periudhës elektorale, ndoshta edhe gjatë periudhës nëntëmuajore, nëse ata konkurrojnë, nëse ata janë pjesë e stafeve elektorale apo janë pjesë e partive politike. Ligji nuk i parashikon, rregullorja e KQZ-së nuk e parashikon, përveç një numri zyrtarësh, të cilët janë shumë të

kufizuar. Por ne flasim për zyrtarët, sidomos për ata që kanë vendimmarrje mbi stafe, mbi njerëz; kanë rroga; kanë fonde; kanë investime deri te niveli i rektorit dhe i dekanit në universitete.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Element tjetër, ne i detyrojmë me ligj partitë politike të bëjnë deklarin e burimeve të financimit dhe një nga tri kriteret është kuota e anëtarësisë. Nëse ne marrim kriterin e kuotës së anëtarësisë, Shqipëria ka vetëm gjashtë parti politike. Do të duhet të jemi seriozë. Nëse partitë kanë anëtarë, do të duhet të na tregojnë se kanë anëtarë dhe se zbatojnë ligjin, madje të tregojnë se kush janë anëtarët e tyre, jo me listë emërore, por të depozitojnë të dhëna zyrtare çdo vit pranë një organi, që mund të jetë një zyrë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për strukturat e tyre lokale, për kontaktin e tyre me drejtuesit lokalë, për strukturat funksionale dhe policën e anëtarësisë, në mënyrë që deklarimi që ndodh pas zgjedhjeve të na japë mundësinë për të bërë ballafaqimin midis të dhënave.

Po ashtu, mendoj se me këtë lidhet edhe një detyrim ligjor që e kanë shumë vende, sipas të cilit, ngaqë shumica e partive në Shqipëri janë fiktive, do të duhet të shtohet kriteri që kur një kandidat regjistrohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve duhet të sjellë aktin zyrtar të partisë, që partia ekziston, që partia ka struktura, që ka përmbushur detyrimin e ligjit të partive politike për të deklaruar periodikisht pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë zgjedhjen e strukturave dhe vendimmarrjen politike, si dhe që ky individ ka vërtet një vendimmarrje nga një strukturë e caktuar apo parti politike.

Nëse ne vazhdojmë me mekanizmin që presim orën 12 të natës për të dorëzuar listën e fundit, praktikisht nuk po bëjmë asgjë, por do të kthehemi dhe do të thinjemi në këtë sallë.

Një element tjetër lidhet me dekriminalizimin. Unë kam bërë një studim nga Instituti, të cilin ua kam dërguar, në mos gaboj, grupeve kryesore parlamentare dhe drejtuesve të parlamentit, është edhe publik në faqen tonë të internetit. Ky është i vetmi studim në Shqipëri për dekriminalizimin dhe ne aty kemi parë shumë elemente tek të cilët do të duhet të ketë ndërhyrje, për shkak se procesi, i cili do të duhet të kishte rezultate maksimalisht, ka përfunduar në rezultate minimaliste, domethënë deri atje sa edhe një individ, që u largua nga dekriminalizimi, konkurroi sërish për zgjedhje ose është ende në poste të caktuara politike. Madje një element, që ka ndikim edhe në zgjedhje, është fakti se të gjithë individët që largohen qoftë nga parlamenti, nga institucionet publike dhe politike për shkak të dekriminalizimit, do të duhet që me ligj të detyrohen të largohen nga strukturat e partive politike. Çfarë kuptimi ka të largohet nga parlamenti dhe ta caktojme shef elektoral të një qyteti të caktuar, kur pushteti i tij si shef elektoral është shumë më i madh sesa pushteti i një

deputeti në parlamenti?! Edhe ne aktualisht i kemi, ku nga pesë të larguar, katër drejtojnë fushatën elektorale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një element tjetër lidhet, po ashtu, me konceptin e financimit. Unë personalisht jam partizan i konceptit gjerman, po themi, “1 votë, 1 euro” me këmbimin shqiptar, që do të thotë: nëse një kandidat dhe një parti konkurron dhe merr një votë, le të paguhet për atë votë. Por nuk ka sens që ne t’u themi: regjistrohuni si parti. Nëse merrni në tri zgjedhje një numër votash, nëse siguron mandatin, nëse hyni në koalicion e të tjerë dhe të mbajmë në këmbë subjekte fiktive. Edhe vetë parlamenti ka një grup parlamentar që është fiktiv.

E në momentin kur fillon fiktiviteti në nivelin e lartë, imagjinoni se çfarë ndodh në nivelin poshtë. Pse duhet ne të lejojmë të bëhen trafikime të tilla votash dhe mandatesh, duke detyruar që çdo kandidat dhe çdo subjekt të luftojë për votën e tij? Nëse lufton për votën e tij lidhur me financimin, atëherë do t’i detyrojmë të gjithë aktorët që të maten mirë kur bëjnë, po themi, marrëveshje politike ose kur bëjnë trafik, siç quhet në gjuhën politike.

Këto janë elementet kryesore që lidhen me platformën e përgjithshme.

Unë personalisht e shoh edhe sistemin tonë të kandidimit dhe të prurjeve të reja në politikë, si sistemi më i mbyllur ndoshta në Europë. Ne shohim Italinë apo edhe se çfarë ndodh në vendet e tjera: një parti krijohet nga një numër minimal njerëzish, regjistrohesh dhe konkurron. Ndërsa në Shqipëri, për të krijuar parti, është shumë më e vështirë sesa të bësh mrekulli. Zyrtarisht në Shqipëri, vetëm kandidati për kryetar bashkie të Tiranës, i pavaruri që doli, nëse dilte me një listë kandidatësh, do të duhet të mblidhte shumë më tepër firma sesa iu deshën kryetarit të Bashkisë së Tiranës për të fituar zgjedhjet. Kjo është t’i detyrosh individët të pranojnë këto parti që janë dhe të mos lejosh të hyjnë parti të reja jashtë sistemit, qoftë edhe individë konkurrues, pra qoftë edhe kandidatë. Madje është kaq paradoksale, sa ne kemi bërë hapa pas në vitet e kaluara, sa edhe deputetët në parlament, që vendosin të ndryshojnë pozicion dhe të krijojnë parti, ne i detyrojmë të mbledhin firma për parti, firma për kandidim, firma për kandidatë, duke e bërë të pamundur praktikisht dhe duke shuar shpresat se në këtë vend mund të ketë ndryshime, siç kanë ndodhur në shumicën e Europës së cilës ne duam t’i përkasim.

Këto janë elementet që unë mendova se janë themelore për t’i trajtuar.

Ju thashë, kam një numër prej rreth 60 rekomandimesh teknike, të cilat nuk mendoj se është vendi për t’i diskutuar, por do t’i vendos në dispozicion të çdo anëtari të komisionit dhe nëse do t’i duhet ndonjërit ekspertiza jonë, ne do të jemi gati për këtë.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Krasniqi, për një numër rekomandimesh, çështjesh dhe problematikash që ju shtruat!

Jam i sigurt se ju do të na e vini në dispozicion edhe materialin tjetër që, sigurisht, do të na shërbejë dhe tematikat janë të rëndësishme.

Nevoja për të reformuar ligjin “Për partitë politike” 18 vjet më pas, pasi është miratuar ligji, ndoshta ka ardhur. Deri sot ai është prekur vetëm për pjesën e financimit të partive politike.

Në kuadrin e diskutimit për sistemin zgjedhor, i cili shumë herë ngushtohet vetëm te formula apo te skema bazë e sistemit, kjo është një pjesë e padiskutueshme për diskutim, pra për një modernizim të kuadrit ligjor jo vetëm në raport me Kushtetutën, por edhe më gjerë do të ishte pjesë e atij diskutimi.

Ju ngritët çështjen e përdorimit të burimeve shtetërore, i cili, në fakt, nuk është vetëm burimesh njerëzore dhe, me sa kuptova unë, ju keni të njëjtën qasje, është edhe një nga rekomandimet prioritare të OSBE-ODIHR-it. Pra, besoj se do ta kemi mundësinë për të diskutuar më thellë për të gjitha çështjet që ju ngritët.

Ka pyetje nga deputetët në lidhje me atë çfarë parashtroi zoti Krasniqi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Pra, pasi të marrim informacion, ndoshta do të kemi mundësi të kontaktojmë sërish me ju dhe me përfaqësuesit e tjerë të shoqërisë civile.

Unë jam i sigurt që në planin e punës, që ne do ta realizojmë edhe me tryezat, *workshop*-et, konferencat, do të jeni të pranishëm, do të keni mundësi të kontribuoni edhe në ato evente të tjera thelbësore për punën e komisionit, aty ku do të formohen qëndrimet e komisionit, do të dalin konkluzionet dhe do të jepen draftim dhe ndërhyrje në Kodin Zgjedhor.

Zoti Krasniqi mbylli listën e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, por përpara se ta mbyll këtë mbledhje, sepse edhe deputetët mund të kenë diçka për të thënë, përfitoj nga rasti të falënderoj prezencën e OSBE-së në Shqipëri për materialin që u ka vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve.

Në fakt, është hera e parë që kemi në dispozicion një përmbledhje të akteve, besoj, kryesore të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese apo të Kolegjit Zgjedhor në lidhje me zgjedhjet dhe referendumet, gjithashtu një set dokumentesh, që përcaktojnë standarde në lidhje me procesin zgjedhor, në mënyrë të veçantë për procesin e votimit ose për futjen e teknologjive në votim, dhe një përmbledhje e konferencës shumë të vlefshme që u zhvillua më 13 dhjetor, me mbështetjen e OSBE-së, pikërisht për teknologjitë e reja në votim.

Ju e dini se është çështje prioritare, ndër të tjera, për këtë komision, ndaj përfitoj nga rasti ta falënderoj prezencën e OSBE-së për këtë kontribut dhe për materiale të tjera që na ka vënë në dispozicion si komision!

Ka ndonjë çështje tjetër nga anëtarët deputetë që do të donit ta diskutonim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka.

Duke ju falënderuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Shehi.

Dashmir Shehi – Meqenëse sot qenkemi shumë edhe këtu, edhe andej, thashë të them dy fjalë përtej këtyre çështjeve teknike.

Uroj që zotërinjtë e OSBE-së dhe të ODIHR-it do të na ndihmojnë kësaj radhe, që të bëjmë, me gjithë mend, një ndryshim rrënjësor për zgjedhjet, meqenëse kemi edhe kohë të mjaftueshme nga këtu deri kur të vijnë zgjedhjet e tjera, sepse zakonisht ne mblidhemi dy muajt e fundit dhe bëjmë arnimet e vogla allashqiptarçe.

Pra, meqenëse kemi shumë kohë, meqenëse jemi shumë njerëz dhe meqenëse kemi shkruar shumë libra, them që kësaj radhe të fillojmë seriozisht të ndryshojmë diçka. Domethënë, të ndryshojmë mënyrën si të votohet, që të mos i vjedhim votat; të ndryshojmë sistemin, që të mos na prodhojë kriminelë në parlament dhe mospërfaqësime; ta modernizojmë ligjin “Për partitë politike”, që të mos kemi të gjitha problematikat që përmendi zoti Krasniqi në fund.

Me pak fjalë, meqenëse kemi kohë dhe njerëz, të bëjmë diçka që nuk është bërë herët e tjera.

Kjo ishte e gjitha, pasi më kapi një lloj entuziazmi kur pashë kaq shumë njerëz të interesuar përtej një çështjeje dhe mendova që, si deputet i vjetër, ta mbyllim me njëfarë embëlsire, kështu, të shpresojmë.

Ne kemi shumë besim që ju do të na jepni ndihmën e domosdoshme që ne të arrijmë të kemi zgjedhje të pranueshme në Shqipëri, duke filluar nga ato administrative, që janë vitin që vjen, për të përfunduar nga ato politike, që janë tre vjet më vonë.

Sepse, në qoftë se nuk ndërhyhet në sistem, tre vjet janë avantazh, me gjithë mend, për t’i përmirësuar gjërat, por kur marrin rrugët për keq, tre vjet në Shqipëri janë një kohë kaq e madhe për ta sofistikuar çfarëdolloj sistemi, për ta vjedhur e për ta rivjedhur...

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Shehi!

Me këtë notë pozitive nga ju, edhe unë besoj vërtet se kemi të gjithë hapësirën, kohën, e shpreh këtë edhe në emrin e kolegut Çuçi, si bashkëkryetar, që të punojmë me intensitet të lartë, por me një organizim të mirë për të arritur ndryshime thelbësore në kornizën zgjedhore. Plani i punës do të na ndihmojë për këtë.

Është shumë i rëndësishëm angazhimi i gjithsecilit prej nesh, si anëtarë, por edhe i ekspertëve për të arritur në këtë konkluzion.

Përfaqësuesit e OSBE-ODIHR-it janë të gatshëm të marrin pjesë, për shembull, edhe në mbledhjen e ardhshme të komisionit, çka është një tregues mjaft i fortë, por jam i sigurt edhe partnerët e tjerë, i të gjithë këtij angazhimi tonin të përbashkët.

Edhe një herë, duke ju falënderuar për këtë mbledhje, ju uroj ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA